

SI LINDI MUZEU KOMBËTAR I ARTIT MESJETAR, KORÇË

Historia e Muzeut Kombëtar të Artit Mesjetar ka një prehistori:

Mbas luftës dhe rezultatit të pabesueshëm për atë kohë që arritëm për ruajtjen maksimale të numrit të monumenteve, së bashku me Theofan Popën, Gani Strazimirin dhe Leka Meksin, një tjetër aksion madhor na priste: dokumentimi dhe grumbullimi i ikonave dhe objekteve të tjera fetare me vlerë nga ndërtesat e pashpallura ose të hequra nga lista e Monumenteve të Kulturës, punë të cilën e përballoi pothuajse i vetëm Theofan Popa. Vetëm po të njohësh numrin e ikonave dhe objekteve të tjera fetare me vlerë, po të dish se ku ndodhen kishat nga të cilat këto objekte janë mbledhur, si dhe në çfarë kushtesh ato janë mbledhur, vetëm atëhere mund t'i kuptosh dhe t'i çmosh përmasat e kësaj pune kolosale të Theofanit. Mjafton të përmendim se mbi gjashtëmijë ikona dhe objekte të tjera kishtare ruhen në fondet e Muzeut të Artit Mesjetar në Korçë dhe pothuajse po kaq në Berat, Gjirokastër e gjetkë.

Në kohën kur kishte filluar shembja ose transformimi i ndërtesave të kultit: Kishës katedrale “Burimi Jetëdhënës” të Korçës i ishin prishur kambanaret, xhamia e Durrësit ishte kthyer në shtëpi rinie, kisha e Madhe e Shkodrës në pallat sporti etj., ndryshe nga propozimi i Korçës që kisha të kthehej në teatër rinie ose ndonjë destinacion tjetër, vjen nga lart urdhëri që kjo kishë të kthehej në Muze Ikonash.

Projekti i modifikimit u hartua nga Pirro Thomo dhe Ali Muka, arkitektura, Skënder Luzati, konstruksioni. Kishës ju shtua një pjesë në anën perëndimore, për ambientet e punës së muzeut dhe një pjesë në anën lindore, për sallën e ekspozitës së muzeut. Muzeu përmbante: sallën e ekspozimit të përhershëm, sallën e konferencave dhe leksioneve, që mund të shërbente dhe për ekspozita të përkohëshme dhe tematike, sallat e resturatorëve, dhomën e arkivës, përpunimit dhe skedimit të objekteve, sallën e skedarëve dhe të studimit të shkencëtarëve të ndryshëm të interesuar për artim mesjetar, laboratorin fotografik, sallën e fondeve, të vendosur në katin e sipërm të ndërtesës.

Grupi i platformës së muzeut përbëhej nga Skënder Anamali, Dhorka Dharmo, Andromaqi Gjergji dhe Pirro Thomo, me konsulencën shkencore të Prof. Aleks Budës.

Projekti i gjithë pajisjeve, si dhe aranzhimi i sallës së ekspozitës së përhershme u krye nga Pirro Thomo.

Salla e ekspozitës së përhershme përmbante një gamë shumë të gjerë objektesh, që përfaqësonte gjithë gjinitë e artit mesjetar: objekte guri, si pjesë të skulpturës dekorative, fragmente mozaikësh mesjetarë, ikona dhe pjesë ikonostasi, si dhe ikonostasin origjinal të kishës së vjetër “Burimi Jetëdhënës”, objekte në argjend e ar të përdorimit liturgjik e popullor, si dhe objekte të artit popullor. Fondi i ikonave dhe objekteve të tjera, mbi 6500 objekte, ishin sistemuar në katin e sipërm në telajo me rrjetë teli, mënyrë që për herë të parë përdorej në Shqipëri.

Muzeu u përrua më 24 prill 1980 në prani të personaliteteve të larta shtetërore, të Akademisë së Shkencave, të rrethit të Korçës, punonjësve të shkencës e kulturës, qytetarë etj. Në krye të institucionit u emruan personalitete të kulturës e shkencës, si skulptori Avni Bilbili, historiani Franklin Xega etj. Këtu u formuan restauratorët e parë, Kristofor Naslazi, Koço Ristani, Kristaq Balli, Tatjana Caca etj. Muzeu është vizituar nga mijëra vizitorë vendas e të huaj dhe, siç del jo vetëm nga bisedat gojore, por dhe nga librat e përshtypjeve, është cilësuar nga të huajt si muzeu më i kompletuar dhe instruktues i Shqipërisë.

Mbas 1991 salla kryesore e ekspozitës së përhershme iu dha kishës dhe ekspozita u zhvendos në sallën e konferencave, duke humbur një pjesë të shkëlqimit të sallës fillestare.

Gjatë jetës së tij Muzeu ka patur një jetë shumë të gjallë kulturore e shkencore, nëpërmjet emisioneve, leksioneve, artikujve në organet shkencore dhe popullarizuese. Muzeu ishte një furnizues kryesor me objektet e tij për ekspozitat e hapura në shumë vende të botës. Aktiviteti më i rëndësishëm ishte bashkëpunimi shumëvjeçar me Muzeun prestigjioz të Kulturës Bizantine të Selanikut, ku, së bashku me restauratorët grekë, u restauruan 88 ikona. Në përfundim u hap një ekspozitë me ikonat e Korçës, si dhe u botuan manuali i restaurimit të ikonave në shqip dhe greqisht dhe katalogu i ekspozitës në anglisht dhe greqisht.